

# PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE

Drejtuar: AKM-TIRANË

Për dijeni: DRM Tiranë-Durrës-Dibër

Kërkesë për pjesëmarrje në organizimin e konsultimit me publikun dhe palët e interesuara për aplikimin për Leje Mjedisi Tipi B



"Industria minerare", ID:3.1/d Magazinimi, ngarkimi ose shkarkimi në masë të madhe i çimentos ose i klinkerit të çimentos përpara transportimit të tyre në masë të madhe.

SUBJEKTI: "W-BEN" SH.P.K.

ADMINISTRATOR: Arben AJDINI

VENDNDODHJA E INSTALIMIT: PRANË URËS SË BESHIRIT, MENIK, N.J.A.  
NDROQ, BASHKË TIRANË

*Arben Ajdini*  


Ekspert mjedisi Ledjana BOJAXHI *L.B.*



## 1. PROFILI I OPERATORIT

Shoqëria "W-BEN" shpk e regjistruar pranë QKB me nr. NIPT K12226002G, e themeluar më datë 07.10.2001, me administrator z. Arben Ajdini dhe me seli pranë Urës së Beshirit, Ndroq, Tiranë kërkon të pajiset me leje mjedisi të tipit B për të ushtruar aktivitetin që klasifikohet sipas ligjit të lejeve të mjedisit, në kategorinë "Industria minerare", ID:3.1/d Magazinimi, ngarkimi ose shkarkimi në masë të madhe i çimentos ose i klinkerit të çimentos përpara transportimit të tyre në masë të madhe.



REPUBLIKA E SHqipërisë  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
DZMORA KOMBËTARE E BIZNESIT

### EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

#### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	K12226002G	
2. Data e Regjistrimit	26.10.2001	
3. Emri i Subjektit	W - BEN	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	07.10.2001	
6. Kohëzgjatja	Nga: 07.10.2001	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Turrise Ndroq MENIK, Kapanon, pranë Urës së Beshirit	
8. Kapitali	100 000.00	
8.1. Numri i përgjithshëm i listave	2.00	
9. Objektiv i aktivitetit	Tregtimi me shumicë e pakicë dhe import eksport në mallrave industriale, ushqimore, lëndë të para, pajisje veshmbathje e konfektione, hidrosanktare, hidraulike, elektrike, kancelari për zyra e shkolla, orëndi shpejtë, mobilje, pajisje elektrike e elektroshpejtë, kuzhlet, elektro-shpejtë, friza perime, produkte bujqesore e biqesore, produkte në durr, bima medicinale essenciale e mjekësore, produkte kozmetike dhe estetike, kimike dhe derivate, pjesë këmbimi për makina dhe aksesore, poma, bateri. Përkrahje servisi.Produktim e tregtim të materialeve të ndërtimit, merrve, pllaka betoni, blloqe betoni, solera të ngjeshme të ndërtimit, pllaka metalike Transport. Altrah për veturë dhe për të tregu të vendit e jashtë vendit.	
10. Administratori në	Arben Ajdini	
10.1. Afat i emërimit	Nga: 29.06.2024	Data: 29.06.2024
11. Procedura e emërimit të administratorit nga parashikimet ligjore		
11.1. Konfirmimi e kompetencave (nëse ka)		

## 2. VENDNDODHJA E USHTRIMIT TË AKTIVITETIT

Subjekti ka qenë i pajisur më parë me Leje Mjedisi të Tipit C, një kategori që aktualisht nuk është më në fuqi sipas ndryshimeve të legjislacionit mjedisor. Që nga themelimi i subjektit, aktiviteti i ushtruar, procesi teknologjik, infrastruktura ekzistuese dhe kapaciteti prodhues kanë mbetur të pandryshuar. Aktualisht, subjekti nuk ushtron aktivitetin deri në pajisje me leje tipi B, në përputhje me kategorizimin në fuqi. Në vijim janë koordinatat e vendndodhjes, paraqitja në hartë topografike si dhe foto nga zona e ushtrimit të aktivitetit.

Prona	KOORDINATAT	
		476001.022
	476082.222	4572516.263
	476086.422	4572467.263
	476069.342	4572463.343
	476070.742	4572428.903
	476016.142	4572422.183





Figura 1 Pamje nga aktiviteti

### 3. PËRSHKRIMI I VEPRIMTARISË

Veprimtaria që do të zhvillohet në këtë instalim klasifikohet në kategorinë "Industria minerare", ID:3.1/d Magazinimi, ngarkimi ose shkarkimi në masë të madhe i çimentos ose i klinkerit të çimentos përpara transportimit të tyre në masë të madhe.

Në kuadër të këtij aplikimi nuk parashikohet realizimi i punimeve ndërtimore apo ngritja e objekteve të reja, pasi aktiviteti është ekzistues dhe infrastruktura përkatëse është funksionale që prej vitit 2001. Për rrjedhojë, nuk do të përdoren materiale ndërtimi për fazë ndërtimi.

Sa i përket zhvillimit të aktivitetit prodhues ekzistues, lëndët e para që përdoren në procesin teknologjik për prodhimin e pllakave, blloqeve të betonit dhe kunetave janë: rërë e bardhë, rërë e zezë, çimento, ujë dhe në raste të veçanta, ngjyrues për prodhimin e elementeve me ngjyrë. Rëra, çimentoja dhe ngjyruesit sigurohen nëpërmjet kontratave të rregullta furnizimi me subjekte të tjera prodhuese dhe tregtuese të këtyre materialeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Furnizimi realizohet sipas nevojave të aktivitetit dhe në varësi të kërkesës së tregut. Uji i përdorur në proces sigurohet nga një pus ekzistues brenda territorit të subjektit dhe përdoret kryesisht për përzierjen e materialeve në prodhimin e elementeve prej betoni.

Energjia elektrike furnizohet përmes rrjetit publik të shpërndarjes, bazuar në kontratë të rregullt me Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSHEE) dhe përdoret për funksionimin e kazanit përzierës dhe pajisjeve të tjera ndihmëse të procesit prodhues.

### 4. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT DHE TEKNOLOGJISË

Zona ku ushtrohet aktiviteti i subjektit ndodhet jashtë zonave të mbrojtura mjedisore dhe nuk përfshihet në territore me status të veçantë mbrojtjeje. Aktiviteti nuk prek habitate natyrore, nuk ndërhyr në ekosisteme të ndjeshme dhe nuk cënon objekte të trashëgimisë kulturore apo historike. Territori ku zhvillohet veprimtaria është zonë me përdorim të konsoliduar për aktivitete ekonomike dhe nuk paraqet kufizime të karakterit mjedisor apo kulturor.

Sa i përket infrastrukturës së furnizimit me ujë, subjekti përdor ujë të siguar nga një pus ekzistues brenda territorit të pronës. Uji përdoret ekskluzivisht për procesin e përzierjes së

materialeve (prodhimi i elementeve prej betoni) dhe për nevoja higjieno-sanitare. Procesi teknologjik nuk gjeneron shkarkime të ujërave industriale në mjedis dhe nuk ka lidhje me rrjet publik të kanalizimeve për ujëra teknologjike.

Furnizimi me energji elektrike realizohet nëpërmjet rrjetit publik të shpërndarjes, bazuar në kontratë të rregullt furnizimi të lidhur me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSHEE). Lidhja elektrike është e njëjtë me atë të banorëve dhe bizneseve përreth zonës, duke mos kërkuar infrastrukturë shtesë apo linja të dedikuara të tensionit të lartë. Konsumi i energjisë lidhet kryesisht me funksionimin e kazanit përzierës dhe pajisjeve ndihmëse.

Sa i përket aksesit rrugor, vendndodhja e subjektit lidhet me rrugën kryesore përmes një rruge dytësore të shtruar, e cila mundëson hyrje-daljen e mjeteve të transportit për furnizimin me lëndë të para dhe shpërndarjen e produktit të gatshëm. Kjo lidhje rrugore ekzistuese është funksionale dhe nuk kërkon ndërhyrje të reja infrastrukturore apo zgjerime që mund të sjellin ndikime shtesë në mjedis.

Në përfundim, aktiviteti është i integruar në infrastrukturën ekzistuese inxhinierike të zonës dhe nuk kërkon ndërtim të objekteve apo rrjeteve të reja që mund të krijojnë ndikime shtesë mjedisore.

## 5. LËNDËT E PARA DHE FURNIZIMI

Aktiviteti është ekzistues dhe ushtron veprimtarinë e tij që prej vitit 2001, vit në të cilin subjekti është themeluar dhe ka filluar funksionimin. Që nga ajo periudhë e deri më sot, aktiviteti ka vijuar në të njëjtën formë organizimi dhe me të njëjtat parametra teknikë.

Duhet theksuar se që nga themelimi i subjektit nuk ka pasur dhe nuk parashikohet të kryhen punime ndërtimore të reja, ndërsa sipërfaqja e pronës ku zhvillohet aktiviteti ka mbetur e pandryshuar. As makineritë dhe pajisjet ekzistuese nuk janë shtuar apo ndryshuar dhe teknologjia e përdorur në procesin e prodhimit ka mbetur e njëjtë. Gjithashtu, nuk ka pasur rritje apo ndryshim të kapacitetit prodhues, duke garantuar që aktiviteti të vazhdojë të funksionojë në të njëjtat kushte teknike dhe organizative si në fillimet e tij.

Për rrjedhojë, projekti nuk përfshin fazë ndërtimi, pasi infrastruktura dhe ambientet e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit janë ekzistuese dhe funksionale prej vitit 2001.

Sa i përket kohëzgjatjes së funksionimit, aktiviteti konsiderohet me karakter afatgjatë dhe të vazhdueshëm, në përputhje me objektin e veprimtarisë së subjektit. Funksionimi i aktivitetit do të vijojë në të njëjtat kushte teknike dhe organizative, për aq kohë sa do të ekzistojë kërkesë tregu për produktet e prodhuara (si pllaka, blloqe betoni dhe elementë të tjerë prej betoni), pa ndryshime në strukturën, teknologjinë apo parametrat e ushtrimit të aktivitetit dhe në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi për Leje Mjedisori Tip B.

## 6. PROCESI TEKNOLOGJIK

Veprimtaria e subjektit konsiston kryesisht në magazinimin, ngarkimin dhe shkarkimin e çimentos, si dhe në prodhimin e elementeve prej betoni, konkretisht pllaka betoni, blloqe betoni dhe kuneta. Aktiviteti zhvillohet brenda territorit të subjektit, në një sipërfaqe të sistemuar dhe

mbuluar për procesin e prodhimit, magazinimit të lëndëve të para dhe depozitimit të produktit të gatshëm.

Procesi teknologjik përbëhet nga disa faza të ndërthurura. Lëndët e para të përdorura përbëhen nga rëra e zezë, rëra e bardhë, çimento, ujë dhe në raste specifike, ngjyrues për prodhimin e pllakave me ngjyrë. Furnizimi i këtyre lëndëve bëhet nëpërmjet kontratave të rregullta me kompani të licencuara, ndërsa uji sigurohet nga një pus ekzistues brenda territorit të subjektit. Lëndët e para ruhen në ambiente të dedikuara që shmangin shpërndarjen e pluhurave në mjedis. Pas magazinimit, materialet përzihen në një kazan industrial (betoniere) në raportet e nevojshme teknologjike, duke formuar një masë homogjene. Në rastet kur prodhohen pllaka me ngjyrë, shtohet edhe ngjyruesi përkatës gjatë përzierjes. Masa e përfutur hidhet më pas në kallëpe të posaçme metalike, të përshtatura për formën dhe dimensionet e produktit final. Pasi formohen, produktet nxirren në ambient të hapur brenda territorit të subjektit dhe lihen të thahen natyrshëm nga dielli dhe ajri, pa përdorimin e furrave apo pajisjeve të tjera që mund të shkaktojnë emetime në ajër. Kur pllakat dhe blloqet arrijnë fortësinë e nevojshme, ato ambalazhohen dhe magazinohen në zona të dedikuara, në pritje të transportit dhe tregtimit.

Kapaciteti prodhues i subjektit ka mbetur i njëjtë që nga fillimi i aktivitetit dhe aktualisht nuk ka prodhim aktiv. Fuqia punëtore aktualisht përbëhet nga dy persona dhe nuk ka pasur shtim të linjave të prodhimit, ndryshim teknologjie apo zgjerim të sipërfaqes së ambientit të punës. Gjatë procesit të prodhimit mund të gjenerohen sasi të vogla pllakash të krisura ose të thyera. Këto materiale përdoren pjesërisht për sistemime të cepave në territore të ndryshme, ndërsa pjesa tjetër riciklohet nëpërmjet makinerive ekzistuese, duke u kthyer si lëndë e parë sekondare (përzierje rëre dhe çimento) në procesin prodhues. Subjekti nuk gjeneron mbetje të rrezikshme, ndërsa mbetjet urbane menaxhohen përmes shërbimeve të NJQV. Mbjetet e gjeneruara nga puntorët gjatë orarit të punës (letër/karton, plastikë, metal, qelq, mbetje organike) depozitohen në koshat e përcaktuara nga njësia e qeverisjes vendore.

Ndikimi në mjedis i aktivitetit është i kufizuar dhe i kontrollueshëm. Burimet kryesore të emetimeve në ajër lidhen me pluhurat nga magazinimi dhe lëvizja e rërës dhe manipulimi i çimentos, të cilat kontrollohen përmes sistemimit të materialeve në zona të përcaktuara, kufizimit të shpërndarjes gjatë ngarkim-shkarkimit dhe mirëmbajtjes së rregullt të sipërfaqeve. Nuk ka djegie apo emetime gazrash industriale. Procesi nuk gjeneron shkarkime ujërash industriale, përdorimi i ujit është vetëm për përzierje dhe zhurma e gjeneruar nga kazani përzierës dhe makineritë ndihmëse është e kufizuar. Aktiviteti zhvillohet brenda një territori të përcaktuar dhe të sistemuar, pa depozitime të pakontrolluara.

Në përfundim, aktiviteti i subjektit është i njëjtë me atë të ushtruar më parë nën Leje Mjedis Tip C, pa ndryshime në teknologji, kapacitet apo proces funksionimi. Procesi prodhues është relativisht i thjeshtë, pa përdorim të substancave të rrezikshme, pa shkarkime industriale dhe pa përdorimin e furrave që mund të ndikojnë në ajër. Menaxhimi i lëndëve të para, riciklimi i materialeve të thyera dhe mungesa e proceseve ndotëse e bëjnë ndikimin në mjedis të kontrollueshëm dhe në përputhje me parametrat e kërkuar për një aktivitet që kategorizohet për pajisje me Leje Mjedis Tip B.

## 7. INFRASTRUKTURA DHE LIDHJET

Zona ku do të vendoset impianti disponon infrastrukturë të përshtatshme për funksionimin e tij. Furnizimi me energji elektrike realizohet përmes një kabine ekzistuese me kapacitet 250 kVA, e cila përballon nevojat e linjës teknologjike.

Gjithashtu, zona ka akses të mirë në rrugët ekzistuese, duke mundësuar furnizimin me lëndë të para dhe shpërndarjen e produktit përfundimtar pa krijuar ngarkesë të konsiderueshme në trafikun lokal.

## **8. NDËRTIMI DHE INSTALIMI**

Në kuadër të këtij aplikimi nuk parashikohet realizimi i punimeve ndërtimore apo instalimi i linjave të reja teknologjike. Aktiviteti është ekzistues dhe zhvillohet në infrastrukturë të ngritur dhe funksionale që prej vitit 2001.

Që nga fillimi i aktivitetit nuk janë kryer zgjerime të sipërfaqes, ndërtim objektesh të reja apo ndryshime në organizimin strukturor të ambientit. Gjithashtu, makineritë dhe pajisjet ekzistuese nuk janë zëvendësuar apo shtuar, duke vijuar të përdoret e njëjta linjë teknologjike. Për rrjedhojë, nuk ka procese ndërtimore apo instalimi për t'u përshkruar, pasi aktiviteti mbetet i pandryshuar në aspektin fizik dhe teknik.

## **9. KOHËZGJATJA E PROJEKTIT**

Aktiviteti është ekzistues dhe ushtron veprimtarinë e tij që prej vitit 2001, vit në të cilin subjekti është themeluar dhe ka filluar funksionimin. Që nga ajo periudhë e deri më sot, aktiviteti ka vijuar në të njëjtën formë organizimi dhe me të njëjtat parametra teknikë.

Duhet theksuar se që nga themelimi i subjektit nuk ka pasur dhe nuk parashikohet të kryhen punime ndërtimore të reja, ndërsa sipërfaqja e pronës ku zhvillohet aktiviteti ka mbetur e pandryshuar. As makineritë dhe pajisjet ekzistuese nuk janë shtuar apo ndryshuar dhe teknologjia e përdorur në procesin e prodhimit ka mbetur e njëjtë. Gjithashtu, nuk ka pasur rritje apo ndryshim të kapacitetit prodhues, duke garantuar që aktiviteti të vazhdojë të funksionojë në të njëjtat kushte teknike dhe organizative si në fillimet e tij.

Për rrjedhojë, projekti nuk përfshin fazë ndërtimi, pasi infrastruktura dhe ambientet e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit janë ekzistuese dhe funksionale prej vitit 2001.

Sa i përket kohëzgjatjes së funksionimit, aktiviteti konsiderohet me karakter afatgjatë dhe të vazhdueshëm, në përputhje me objektin e veprimtarisë së subjektit. Funksionimi i aktivitetit do të vijojë në të njëjtat kushte teknike dhe organizative, për aq kohë sa do të ekzistojë kërkesë tregu për produktet e prodhuara (si pllaka, blloqe betoni dhe elementë të tjerë prej betoni), pa ndryshime në strukturën, teknologjinë apo parametrat e ushtrimit të aktivitetit dhe në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi për Leje Mjedisi Tip B.

## **10. NDIKIMET NË MJEDIS**

Ndikimi i aktivitetit në mjedis është i kufizuar dhe i kontrollueshëm. Burimet kryesore të ndikimit lidhen me gjenerimin e pluhurave gjatë magazinimit, ngarkim-shkarkimit të çimentos dhe manipulimit të materialeve inerte.

Aktiviteti nuk përfshin procese djegieje dhe nuk gjeneron emetime gazrash industriale në ajër. Gjithashtu, nuk ka shkarkime të ujërave industriale, pasi uji përdoret vetëm për përzierjen e materialeve dhe për nevoja higjieno-sanitare.

Zhurma e krijuar nga pajisjet është e kufizuar dhe brenda niveleve të lejuara për aktivitete të këtij lloji. Aktiviteti zhvillohet brenda një territori të sistemuar, pa depozitime të pakontrolluara dhe pa ndikime të konsiderueshme në mjedisin përreth.

Në tërësi, aktiviteti nuk paraqet rrezik për ndotje të ajrit, ujit apo tokës dhe është në përputhje me kërkesat mjedisore për Leje Mjedis Tip B.

## **11. MASAT MBROJTËSE**

Për të minimizuar ndikimet në mjedis, subjekti zbaton një sërë masash mbrojtëse, ndër të cilat: Sistemimi dhe magazinimi i materialeve në zona të përcaktuara për të shmangur përhapjen e pluhurave;

Kufizimi i shpërndarjes së materialeve gjatë proceseve të ngarkim-shkarkimit;

Mirëmbajtja e rregullt e sipërfaqeve të punës dhe pastrimi periodik i ambientit;

Përdorimi racional i ujit dhe energjisë elektrike;

Kontrolli i zhurmave përmes mirëmbajtjes së pajisjeve ekzistuese;

Organizimi i punës brenda territorit të subjektit për të shmangur ndikimet jashtë tij.

Këto masa sigurojnë që aktiviteti të zhvillohet në mënyrë të kontrolluar dhe me ndikim minimal në mjedis.

## **12. MENAXHIMI I MBETJEVE**

Gjatë ushtrimit të aktivitetit gjenerohen sasi të vogla mbetjesh jo të rrezikshme. Mbetjet kryesore përfshijnë materiale të dëmtuara (pllaka apo blloqe të thyera), si dhe mbetje urbane nga aktiviteti i përditshëm.

Materialet e dëmtuara riciklohen pjesërisht brenda procesit prodhues, duke u përdorur si lëndë e parë sekondare. Pjesa tjetër mund të përdoret për sistemime të ndryshme brenda territorit.

Mbetjet urbane (letër, plastikë, metal, qelq dhe mbetje organike) grumbullohen në mënyrë të diferencuar dhe depozitohen në koshat e përcaktuar nga njësia e qeverisjes vendore, duke u menaxhuar përmes shërbimeve përkatëse. Subjekti nuk gjeneron mbetje të rrezikshme.

## **13. SIGURIA DHE EMERGJENCAT**

Subjekti zbaton masa për garantimin e sigurisë në punë dhe për menaxhimin e situatave emergjente.

Ambienti i punës është i organizuar dhe pajisjet mirëmbahen rregullisht për të shmangur rreziqet teknike. Punonjësit janë të pajisur me mjete mbrojtëse individuale dhe janë të informuar mbi rregullat bazë të sigurisë në punë.

Në rast emergjencash (si zjarre apo incidente të tjera), merren masa të menjëhershme për izolimin e situatës dhe njoftimin e strukturave përkatëse. Në ambientet e subjektit janë të disponueshme mjete bazë për mbrojtje nga zjarri.

#### **14. PËRPUTHSHMËRIA ME PLANIFIKIMIN**

Aktiviteti i subjektit është në përputhje me planifikimin territorial dhe përdorimin e tokës në zonën ku zhvillohet. Zona karakterizohet nga përdorim për aktivitete ekonomike dhe nuk bën pjesë në zona të mbrojtura apo me kufizime të veçanta mjedisore.

Veprimtaria nuk bie në kundërshtim me planet vendore të zhvillimit dhe nuk cenon funksionet e zonave përreth. Gjithashtu, nuk ka ndikime në habitate natyrore, objekte të trashëgimisë kulturore apo elementë të tjerë të mbrojtur.

Për rrjedhojë, aktiviteti është i përshtatshëm me kontekstin urban dhe mjedisor të zonës ku ushtron veprimtarinë.

#### **15. BAZA LIGJORE**

1. Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 'Për mbrojtjen e mjedisit', i ndryshuar;
2. Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 'Për vlerësimin e ndikimit në mjedis', i ndryshuar.
3. Ligji nr.10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër".
4. Ligji nr. 81, datë 04.07.2017 "Për zonat e mbrojtura" i ndryshuar.
5. Ligji nr.10 253, datë 11.3.2010 "Për gjuetinë".
6. Ligji Nr. 57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet".
7. Ligji Nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar.
8. Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", i ndryshuar.
9. Ligji nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis", i ndryshuar.
10. Ligji nr.155/2020, datë 17.12.2020 "Për ndryshimet klimatike".
11. Ligji nr.27/2016, datë 17.03.2016 "Për menaxhimin e kimikateve".
12. Ligji nr.9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", i ndryshuar.
13. Ligji nr.57/2025, datë 16.10.2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".
14. VKM nr. 686, datë 29.07.2015 'Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore'.
15. VKM nr. 247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore".
16. VKM nr.123, datë 17.02.2011 "Për miratimin e Planit Kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis".

17. VKM nr. 575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
18. VKM nr.418, datë 27.05.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035".
19. VKM nr. 371, datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre".
20. VKM nr. 418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim".
21. VKM nr. 229, datë 23. 04. 2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit".
22. VKM nr.519, datë 30.6.2010 "Parqet Natyror Rajonal".
23. Vendim Nr. 22, datë 9.1.2008 "Për caktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal"
24. VKM Nr. 1354, datë 10.10.2008 "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor".
25. VKM Nr. 396, datë 21.06.2006 "Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore".
26. VKM nr.897. datë 21.2.2011 "Miratimi i Rregullave për Shpalljen e Zonave të Veçanta të Ruajtjes".
27. VKM nr. 31, datë 20.01.2016 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit".
28. VKM nr. 676, datë 20.12.2002 "Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare".
29. VKM nr. 594, datë 10.09.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit".
30. VKM Nr. 412, datë 19.06.2019 "Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit".
31. VKM nr 352, datë 29.04.2015. "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të".
32. VKM nr.123, datë 17.02.2011 "Për miratimin e Planit Kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis".
33. Udhëzim i përbashkët nr.2, datë 15.11.2023 "Për nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive ekonomiko-shoqërore".
34. VKM nr. 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë".
35. VKM nr.402, datë 30.06.2021 "Për miratimin e katalogut të mbetjeve".